

PREFECTURA DIBER

Ardhur

Nr. 117 dt 10.12.25



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR  
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

6992

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Peshkopi, më 10/12/2025

**Lënda:** Dërgim vendimi

**Drejtuar:** Prefekti i Qarkut Dibër


Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr. 92

**Datë:** 05.12.2025 .

**“Për miratimin e heqjes së tarifës mujore për çerdhet dhe kopshtet për fëmijet e grave kryefamiljare dhe mbështetjen e grave sipërmarrëse duke i përjashtuar nga tarifat vendore për votin e parë të punës si biznes , në Bashkinë Dibër”**

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

**Sekretari i Këshillit Bashkiak**



Kopje  
10.12.2025  
[Signature]



4992/11/12/25

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT DIBER

Nr.1117/1 prot.

Peshkopi, më 11.12.2025

Lënda : Për vendimin nr.92, datë 05.12.2025 të Këshillit të Bashkisë Dibër.

**KËSHILLIT BASHKIAK DIBËR**

**BASHKISË DIBËR**


DIBËR

Në mbështetje të ligjit nr.107, datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, neni 16, pas verifikimit për efekt ligjshmërie të vendimit të Këshillit të Bashkisë Dibër nr.92, datë 05.12.2025 “*Për miratimin e heqjes së tarifës mujore për çerdhet dhe kopshtet për fëmijët e grave kryefamiljare dhe mbështetjen e grave sipërmarrëse duke i përjashtuar nga tarifat vendore për vitin e parë të punës si biznes, në Bashkinë Dibër*”, vendosa:

Miratimin në parim të vendimit objekt verifikimi dhe shqyrtimi të bazueshmërisë ligjore, në kushtet e respektimit të kuadrit ligjor përkatës, nën përgjegjësinë direkte administrativo-ligjore të strukturave të posaçme të bashkisë që paraqesin per miratim projekt-aktin.

**PREFEKTI**

Nexhbedin SHEHU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR  
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 92 Datë 05 / 12 /2025

**“Për miratimin e heqjes së tarifës mujore për çerdhet dhe kopshtet për fëmijet e grave kryefamiljare dhe mbështetjen e grave sipërmarrëse(kryefamiljare) duke i përjashtuar nga tarifat vendore për vitin e parë të punës si biznes , në Bashkinë Dibër”**

Në mbështetje të Neneve 108 dhe 115 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 54 e vijues të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemimin e taksave vendore”, Ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijes në Republikën e Shqipërisë, VKM nr. 80 datë 28.01.2015, Strategjisë Kombëtare për Barazi Gjinore 2021-2030, rekomandimeve të Aleancës Gjinore Dibër dhe strukturave të Shërbimit Social të Bashkisë Dibër, Këshilli Bashkiak Dibër në mbledhjen e datës **05.12.2025** me 21 vota pro 0 kundër 1 abstenim :

**VENDOSI:**

1. Të heq tarifën mujore për ndjekjen e çerdhes dhe kopshtit për fëmijet e grave kryefamiljare që jetojnë dhe janë të regjistruara në territorin e Bashkisë Dibër.
  - 1.1 Përfitimi nga masa e heqjes së tarifës është i vlefshëm për cdo vit shkollor, me rishikim të listës së përfituesve në fillim të cdo viti arsimor. Komisioni për Çështjet Sociale dhe Drejtoria e Shërbimeve Sociale pranë
  - 1.2 Bashkia Dibër ngarkohen për identifikimin dhe verifikimin e përfituesve, në bashkëpunim me drejtoritë e çerdheve dhe kopshteve publike.
2. Mbështetjen për gratë sipërmarrëse dhe përjashtimin nga taksat vendore në vitin e parë të aktivitetit.
  - 2.1 Gratë që hapin aktivitet të ri ekonomik në territorin e Bashkisë Dibër, përfitojnë përjashtim nga taksat vendore për vitin e parë të ushtrimit të aktivitetit.
  - 2.2 Subjektet duhet të jenë gra sipërmarrëse, të regjistruar në QKB dhe të ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Dibër.
3. Ngarkohen Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, Drejtoria e Arsimit dhe Çerdheve/Kopshteve Publike Drejtoria e Shërbimit Social, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmërinë ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër.
5. Vendimi u shpall më datë **05.12.2025**.

**Kryetar i Këshillit Bashkiak**



### *KERKESE*

- Për heqjen e tarifës mujore për çerdhet dhe kopshtet për fëmijët e grave kryefamiljare dhe
- Për mbështetjen e grave sipërmarrëse në territorin e Bashkisë Dibër duke i perjashtuar nga tarifat vendore për vitin e parë të punës si biznes

Në mbështetje të:

- Neneve 108 dhe 115 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,
- Neneve 54 e vijues të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore",
- Ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore". i ndryshuar,
- Ligjit nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës në Republikën e Shqipërisë",
- VKM nr. 80, datë 28.01.2015,
- Strategjisë Kombëtare për Barazi Gjinore 2021–2030,
- Rekomandimeve të Aleancës Gjinore Diber dhe strukturave të Shërbimeve Sociale të Bashkisë Dibër,

Me propozim të Aleancës së Grave Këshilltare në Bashkinë Dibër. Këshilli Bashkiak Dibër:

Te vendosi:

#### Neni 1

Heqja e tarifës mujore për ndjekjen e çerdhes dhe kopshtit zbatohet për fëmijët e grave kryefamiljare që jetojnë dhe janë të regjistruara në territorin e Bashkisë Dibër.

#### Neni 2

Përfitimi nga masa e heqjes së tarifës është i vlefshëm për çdo vit shkollor, me rishikim të listës së përfituesve në fillim të çdo viti arsimor.

#### Neni 3

Komisioni për Çështjet Sociale dhe Drejtoria e Shërbimeve Sociale pranë Bashkisë Dibër ngarkohen për identifikimin dhe verifikimin e përfituesve, në bashkëpunim me drejtoritë e çerdheve dhe kopshteve publike.

#### Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:

- Drejtoria e Financave dhe Buxhetit,
- Drejtoria e Arsimit dhe Çerdheve/Kopshteve Publike,
- Drejtoria e Shërbimeve Sociale pranë Bashkisë Dibër.

#### Neni 5

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Dibër dhe në Regjistrin e Akteve të Këshillit Bashkiak.

Neni 6 – Mbështetje për gratë sipërmarrëse dhe përjashtimi nga taksat vendore në vitin e parë të aktivitetit

1. Gratë që hapin një aktivitet të ri ekonomik në territorin e Bashkisë Dibër, përfitojnë përjashtim nga taksat vendore për vitin e parë të ushtrimit të aktivitetit.
2. Subjektet duhet të jenë gra sipërmarrëse, të regjistruara në QKB dhe të ushtrojnë aktivitet në Bashkinë Dibër.

3. Drejtoria e Financave, Drejtoria e Tatimeve Vendore dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik ngarkohen për zbatimin dhe monitorimin.

Propozuesit:

**ALEANCA E GRAVE KESHILLTARE DIBER**


Kryetare: Marjeta Kica



Nënkryetare: D. Mikli



Sekretare: S. Tomçini



## RELACION

Mbi projekt–vendimin “Për heqjen e tarifës mujore të çerdheve dhe kopshteve për fëmijët e grave kryefamiljare dhe mbështetjen e grave sipërmarrëse përmes përjashtimit nga taksat lokale në vitin e parë të aktivitetit”

### 1. Objekti i relacionit

Ky relacion shoqëron projekt–vendimin e paraqitur nga Aleanca e Grave Këshilltare të Bashkisë Dibër, me qëllim argumentimin social, ligjor dhe funksional të nismës së propozuar.

### 2. Qëllimi i projekt–vendimit

Qëllimi i këtij projekt–vendimi është:

- të mbështesë gratë kryefamiljare përmes heqjes së tarifës së ndjekjes së çerdheve dhe kopshteve për fëmijët e tyre;
- të nxisë sipërmarrjen e grave në territorin e Bashkisë Dibër përmes përjashtimit nga taksat lokale për vitin e parë të ushtrimit të aktivitetit.

Këto masa synojnë të lehtësojnë barrën ekonomike, të rrisin pjesëmarrjen e grave në tregun e punës dhe të forcojnë qëndrueshmërinë ekonomike të familjeve.

### 3. Arsyeja dhe nevoja për ndërhyrjen

Nga vlerësimet e Aleancës së Grave Këshilltare, si dhe nga takimet tona me qytetarët është konstatuar se një numër i konsiderueshëm i grave kryefamiljare në Bashkinë Dibër përballen me vështirësi ekonomike dhe sociale, ku pagesa e tarifave mujore të çerdhës dhe kopshtit përbën shpesh një pengesë për punësim apo vijimin e punës.

Po ashtu, evidentohet interes i shtuar për hapjen e bizneseve të vogla nga gratë, por kostot e para fiskale shpesh dekurajojnë sipërmarrjen femërore. Përjashtimi nga taksat lokale në vitin e parë u ofron grave hapësirën e nevojshme për të konsoliduar aktivitetin e tyre.

#### 4. Baza ligjore

Nisma mbështetet në këto akte ligjore dhe strategjike:

- Nenet 108 dhe 115 të Kushtetutës së Shqipërisë (kompetencat e organeve të qeverisjes vendore);
- Neni 54 dhe nenet vijues të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", që parashikojnë dhënien e shërbimeve vendore dhe promovimin e zhvillimit ekonomik lokal;
- Ligji nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës";
- VKM nr. 80, datë 28.01.2015, që përcakton kriteret dhe procedurat për tarifatat e reduktuara të shërbimeve sociale;
- Strategjia Kombëtare për Barazi Gjinore 2021–2030;
- Strategjia e BE për Barazi Gjinore 2020–2025, e cila promovon pjesëmarrjen e grave në tregun e punës, mbështetjen e sipërmarrjes femërore dhe aksesin e barabartë në shërbime të kujdesit.

#### 5. Përputhshmëria me prioritetet e zhvillimit lokal dhe të BE

Nisma është në harmoni me:


- objektivat e Basnkisë Dibër për rritjen e aksesit në shërbime sociale;
- politikat kombëtare për uljen e pabarazive gjinore;
- udhëzimet e BE për fuqizimin ekonomik të grave dhe mbështetjen e kujdesit ndaj fëmijëve si mekanizëm i integrimin në tregun e punës.


#### 6. Përfitimet e pritshme

- Rritja e shkallës së punësimit të grave kryefamiljare;
- Përmirësimi i mirëqenies së fëmijëve dhe familjeve;
- Rritje e numrit të bizneseve të reja të hapura nga gratë;
- Fuqizim i rolit të grave në zhvillimin ekonomik lokal;
- Përbushje e standardeve kombëtare dhe europiane në fushën e barazisë gjinore.

## 7. Përfundime

Projekt-vendimi paraqet një masë të domosdoshme sociale dhe ekonomike për komunitetin e Bashkisë Dibër dhe krijon kushte reale për përmirësimin e jetës së grave, fëmijëve dhe familjeve në nevojë. Për këtë arsye, propozohet miratimi i tij nga Këshilli Bashkiak.

Udhëheqja Kërcë 

Sira Tomajini 

Dolores 